



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE



	STUDIO PËRMBARIMORE « SPEED SOLUTION »
--	---

Nr. 464 / 56 Prot

Tiranë, më 02.06.2017

Nr. 464 Regj.

URDHËR

HEQJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit - Tiranë

Unë, Genta Tafa (Bungo), Përmbaarues Gjyqësor pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" sh.p.k, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.511 Vendimi, datë 13.10.2016 i Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Vlorë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.464, datë 09.01.2017 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Dega Rajonale Vlorë, ndaj debitorit "PREMTI"-sh.p.k, NUIS K04814846G, me administratore **Znj. Urani Premti** në lidhje me titullin ekzekutiv "Vendim për Dënim Administrativ" Nr.02, datë 14.06.2016

Me Urdhër shkresave Nr.464/6 Prot., datë 23.01.2017, dhe Nr.464/36 Prot., datë 18.05.2017 është kërkuar vendosja e sekuestros mbi aktivet e:

- "PREMTI"-sh.p.k, NUIS K04814846G, me administratore **Znj. Urani Premti**

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA SE:

Më datë 02.06.2017 është ekzekutuar në Llogarinë e Studios Përmbarimore SPEED SOLUTION-sh.p.k, pranë Banka Kombëtare Tregtare sh.a., e gjithë shuma e detyrimit që debitori ka kundrejt Kreditorit Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Dega Rajonale Vlorë.

Në këto kushte, në zbatim të Nenit 616 Pika (a) Nenit 617 të Kodit të Proçedurës Civile dhe Nenit 32, Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. Heqjen e sekuestros konservative mbi aktivet e:

- **"PREMTI"-sh.p.k, NUIS K04814846G, me administratore Znj. Urani Premti të vendosur me anë të shkresave Nr.464/6 Prot., datë 23.01.2017, dhe Nr.464/36 Prot., datë 18.05.2017.**

2. Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju bëj me dije se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Proçedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim proçedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve.

3. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje.

STUDIO PËRMBARIMORE SPEED SOLUTION

PËRMBARUESI GJYQËSOR

GENTA TAFA (BUNGO)

